



## PROCESVERBALI

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Rahovec, e mbajtur më **09.03.2018** me fillim në ora **10.15**. Mbledhjen e kryesoi Kryetari Komunës **Smajl Latifi**.

**Kryetari**- Meqenëse është takimi i parë pas themelimit të anëtareve të ri në të zgjedhur të këtij këshilli në takimin e fundit të mbledhjes së Kuvendit me dt. 16.02.2018. përshëndetje për Nënkryetarin e Komunës z. Fatmir Iska, monitoruesit e OSBE-së, KFORIT, UNMIKUT, Më lejoni që ti përshëndes të gjithë përfaqësuesit e këtij këshilli, përshëndetje për strukturat e qeverisë komunale, përfaqësuesin e FSK-së, komandantin e stacionit të policisë në Rahovec z. Osman, përfaqësuesit e bashkësive fetare, përfaqësuesit e minoriteteve, sektorët komunalë të cilat kanë të bëjnë me fushën e sigurisë në përgjithësi në Komunën e Rahovecit, përfaqësuesit e shoqërisë civile, përfaqësuesin e mediave etj. Kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi. PO ju lexoj rendin e ditës për mbledhjen e sotme:

### Rend dite

1. Gjendja e sigurisë së përgjithshme në Komunën e Rahovecit, diskutimi mbi disa ndodhi të ditëve të fundit.
2. Përfundimet dhe Rekomandimet nga takimi i KKSB-së,
3. Të ndryshme.

**Kryetari** – Të nderuar anëtar të KKSB-së e qes në votim Rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Besoj se e keni të qartë rolin peshën dhe mesazhin të cilin duhet që ta dërgoj këshilli komunal për siguri në bashkësi përkritazi me angazhimet që do ti kemi gjatë 4 viteve, për përmirësim, avancim dhe ndryshim të gjendjes në të gjitha fushat e jetës dhe punës të cilat kanë të bëjnë me rolin përgjegjës dhe detyrat të cilat i ka ky këshill i themeluar me vendim të Kuvendit të Komunës. Kalojmë në pikën e parë:

#### 1. Gjendja e sigurisë së përgjithshme në Komunën e Rahovecit, diskutimi mbi disa ndodhi të ditëve të fundit.

Kohëve të fundit ka pasur disa shqetësime të cilat lidhen me elementin keqbërës, këto shqetësime nuk e dëmtojnë gjendjen e sigurisë së përgjithshme në Komunën e Rahovecit, por ne si Komunë por edhe stacioni policisë në Rahovec ka pranuar shqetësime reale të cilat në fokus i kanë pasur vjedhjet në theks të veçantë në fshatin Opterushë. Në bazë të njoftimeve të cilat ne i kemi nga policia e Kosovës trendi i vjedhjeve në Komunën tonë ka rënë dukshëm, por nuk mundet të harrohet fakti që gati për dy javë ka qen një situatë problematike në fshatin Opterushë, e besoj se organet e rendit i kanë marrë të gjitha masat dhe i kanë kryer punët e tyre, shpresojmë se edhe në këtë takim do të kërkojmë me insistim ndriçimin e kësaj situatë e cila ka marrë përmasat e caktuara shqetësuese, ne kemi pasur edhe një shqetësim medial nga televizionet shtetërore të cilat kanë dhënë lajmin i cili për ne nuk ka qen i këndshëm. Prandaj shfrytëzoj rastin që ti kërkoj Komandantit të stacionit policor dhe gjithë anëtarëve të këshillit të KKSB-së që të kontribuojmë së bashku që situatat e tilla të mos përsëriten në komunën tonë, po ashtu nëse na shfaqen situatat e tilla të kemi një angazhim sa ma serioz në mënyrë që këto shqetësime të zvogëlohen. Ne si komunë kemi problem me lirin e hapësirave publike që nga sheshi në qendër, ne edhe ashtu rrethin e kemi të ngushtuar, nuk kemi infrastrukturë të mjaftueshme ka disa njerëz që vijnë me kamionë parkohen në qendër dhe shesin thëngjill, inspektorati ka kryer punën e vet po ashtu edhe policia ka bërë disa përpjekje në bashkëpunim me inspektoratin e Komunës që të i largojë ata shitës ambulantë aty madje janë kujdesur që të ja gjejnë një vend më të përshtatshëm për shitjen e produkteve të tyre. Deri më tani aksioni i policisë dhe inspektoratit nuk mund të themi se është kryer me sukses, veprimet tona dhe të

policisë nuk po duket që janë veprime që po krijojnë qëndrueshmëri të asaj kërkesë ose të atij vullneti që e kemi ne që të mos ketë shitës ambulantë në qendër të qytetit, shpresoj që policia e Kosovës së bashku me inspektoratin e Komunës do ja rikujtojë sa herë të ketë nevojë në mënyrë që të mos kemi më situata të tilla të cilat e pengojnë zhvillimin normal të qarkullimit të automjeteve në atë pjesë. Kemi po ashtu probleme me lirim të trotuareve, siç e dimë të gjithë trotualet i takojnë këmbësorëve e nuk i takojnë automjeteve të cilat i parkojnë vend e pa vend. Mendoj se këto probleme kërkojnë një koordinim më të mirë me policinë e Kosovës dhe një angazhim nga secili prej nesh në mënyrë që të kemi situata dhe lajme më të mira në të ardhmen për sa i takon lirim të hapësirave publike sepse rrezikojnë jetën e qytetarëve të cilët ecin nëpër trotuare edhe ashtu ju e dini që ne po kemi vështirësi në përmirësimin e infrastrukturës rrugore por sido që të jetë këto që i kemi në dispozicion detyra jonë edhe si komunë edhe si polici e secilit prej nesh është që të i lirojmë trotualet, nuk është dëshira e jonë që ti dënojmë njerëzit, nuk është dëshira e jonë që ti përdorim sipas ligjit vetëm masën e ndëshkimit që qytetarët tonë të paguajnë për gabimet të cilat i bëjnë. Ne të gjithë duhet që të marrim obligim që të bisedojmë me këta njerëz bashkërisht në mënyrë që mos të detyrohemi që një ditë marrin masa ndëshkuese ndaj atyre. Të nderuar anëtar të KKSB-së po ashtu kemi probleme mbeturinat sepse edhe këto kanë të bëjnë me sigurinë e qytetarëve tanë për arsye se hedhja e mbeturinave vend e pa vend po e vështirëson në masë të madhe konceptin për një partneritet më të mirë për investitorët potencial të cilat janë të interesuar që të investojnë në Komunën tonë. Ne duhet që të përdorim ndikimin dhe autoritetin tonë në eliminimin e mbeturinave dhe pamundësimin e hedhjes së mbeturinave në hyrje dhe dalje të qytetit posaçërisht në rrugën Rahovec – Malishevë dhe zonat e tjera të cilat çdo ditë i shohim me sy. Ju e dini që ka pasur një angazhim vullnetar të largimit të mbeturinave të amvisërisë dhe mbeturinave të lëngëta, por një herë e përgjithmonë ne duhet që të marrim masa që mbeturinat të mos përsëriten më në Komunën e Rahovecit. Po ashtu ne kemi probleme edhe me hedhjen e mbeturinave të ngurta, por për këto mbeturina ne jemi duke u përpjekur që të gjejmë zgjidhje në përputhje me planin e veprimit të mbrojtjes së mjedisit dhe në përputhje me një orientim që ka Komuna e Rahovecit dhe të caktohen deponitë ku do të hidheshin mbeturinat e ngurta. Të nderuar anëtarë të KKSB-së po ashtu kemi edhe një situatë goxha problematike në lokucionin ka Brestoci ku përkaj rrugës rajonale Rahovec – Krushë e Madhe pavarësisht se është pronë private është e palejueshme dhe e pa tolerueshme që të shihen grumbuj të dheut dhe mbeturina të shumta të ngurta, deponimet e tilla Komuna jonë nuk duhet që ti toleroj, shpresoj se policia do ti shoqëroj edhe inspektoratin tonë, drejtorin e shërbimeve publike dhe drejtorin e emergjencave në mënyrë që të kemi sa më pak probleme në këtë drejtim. Këto ditë kemi pasur probleme edhe me vërshimet e shumta, kemi pasur probleme me shembje të dheut mbyllje të kanalit, në pika të ulëta kemi pasur probleme me vërshime ku janë përfshirë pronat bujqësore dhe pasuritë ekonomike të familjeve tona, ne si Komunë kemi formuar një komision për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e fundit ende nuk kemi një raporte përfundimtar përkitazi me koston e dëmeve të shkaktuara, **por besoj se edhe në këtë drejtim ne si KKSB mundë të japim kontributin përmes sqarimeve, informacioneve dhe udhëzimeve në lidhje me vetëdijësimin në mënyrë që mos të bëhemi vete shkaktar që këto gjëra të përsëriten. Ne i kemi evidentuar pikat kritike dhe jemi të gatshëm që ti trajtojmë që të evitohen këto rreziqe potenciale që vinë nga vërshimet.** Kisha kërkuar që KKSB-ja nga takimi i sotëm të ketë një platformë të qartë një plan veprimi që ti ushtroj deri në fundë përgjegjësitë dhe ti kryej deri në fundë detyrat e veta së bashku me Kryetarin e Komunës dhe ekipin e tij dhe së bashku me partnerët të cilët marrin pjesë në këtë këshill i cili i ka për detyrë që të i ndihmojë për siguri të përgjithshme gjithë banorët e Komunës së Rahovecit.

**Osman Ismajli, Komandanti i stacionit të Policisë** – Përsëritet për të gjithë të pranishmit në veçanti përbërjen e re të KKSB-së, brenda javës do ju sigurojë një broshurë të gjitha anëtarëve e cila është bazë ligjore e KKSB-së, aty parashihen funksionet detyrat dhe përgjegjësitë e këtij këshilli. I nderuari z. Kryetar ne nga mbledhja e kaluar kemi pasur 4 konkluzë, konkluzë e parë ka qenë sa i përket çështjes së adresimit të kërkesës së MPB dhe të Policisë së Kosovës në lidhje me stacionin e rrënuar në Ratkoc i cili paraqet rrezik, kërkesa është dërguar që 10 ditë presim përgjigje brenda afatit ligjor nga ata që janë kompetent, kërkesa është kompletuar me të gjitha të dhënat, nëse nuk na vije përgjigja ka procedurat të tjera që duhet vazhduar. Pastaj konkluzë e dytë është hartimi i planit të punës së KKSB-së, besoj se shumë shpejtë do të hartohet ky plan, pastaj konkluzë e tretë ka qenë përzgjedhja e anëtarëve të rinj të këtij

këshilli kjo ka përfunduar, konkulza e katërt ka qen sa i përket ankesave të qytetarëve për stallat të cilat janë të vendosura në zonën e qytetit, në zonat e urbanizuara mirëpo edhe në periferi, ankesat që i kemi nga qytetarët e fshatit Hoçë e Madhe, ata ankohen se janë të rrezikuar nga qentë, mendoj se inspektorati do të del në të ardhmen në terren, kjo konkluzë ka mbetur e parealizuar. **Gjendja e sigurisë në Komunën tonë në përgjithësi është e qetë dhe stabile nuk kemi pasur raste të rënda.** Do të fokusohem më gjerësisht tek rastet e vjedhjeve në fshatin Opterushë, ne zakonisht i krahasojmë të dhënat mujore të këtij viti me të dhënat mujore të vitit të kaluar. Gjatë muajit shkurt kemi pasur vetëm një prishje të rendit dhe të qetësisë publike, kurse vitin e kaluar në të njëjtën periudhë kemi pasur tri prishje të rendit dhe të qetësisë publike.

Kriminaliteti- gjendja e sigurisë sa i përket kriminalitetit është e mirë dhe duke krahasuar të dhënat e këtij viti me vitin e kaluar është e mirë, nëse i krahasojmë të dhënat me muajin e vitit paraprak kanë qenë vetëm dy raste më tepër dhe ato raste kanë qenë në fshatin Opterushë. Janë raportuar gjithsej 31 vepra penale kurse 29 vepra penale kanë qenë në vitin paraprak. Rastet më të rënda po them të cilat janë rastet e lehta në krahasim me ato që konsiderohen të rënda ka qenë 1 lëndim i rëndë trupor, 4 lëndime të lehta, 6 vjedhje dhe 11 vjedhje të rënda, me statistikën e vitit të kaluar jemi aty afër. Incidente jo penale kanë qenë 6 në muajin e kaluar kurse 13 në vitin paraprak po në të njëjtin muaj. Sa i përket totalit të rasteve nga 37, vitin e kaluar kanë qenë 43 pra kemi një rrënjë -14%. Dhuna në familje kanë qenë 3 raste në këtë muaj, incidente në shkollë kemi pasur 1 rast në gjimnaz i dyshuari është akuzuar ka qenë në mbajtje 48 orë pasi me dhunë ja ka marrë një telefon një nxënës të shkollës, ka qenë edhe një rast e grafitëve në gjimnaz ku disa nxënës kanë vizatuar me ngjyra të ndryshme dhe me të vërtetë e kanë dëmtuar imazhin dhe pamjen e shkollës, kishte me qenë mirë që të ndërmyrren masat dhe të sanohet ajo gjendje. Siguria në komunikacionin rrugor, ka qenë e mirë edhe përkundër që kemi pasur të reshura dhe temperatura të ulëta, mirëmbajtja e rrugëve është bërë edhe nga kompanitë të cilat mbulojnë rrugët magjistrale dhe rajonale edhe Drejtoria e Shërbimeve Publike e Komunës së Rahovecit me kompaninë e ambientit ka qenë mjaft aktive dhe i kanë pastruar rrugët lokale. Normalisht se diku ka pasur vonesa nga pak sepse nëse shkon në fshatin Zatriq nuk mund të kthehesh para tre orëve por varësisht nga situata dhe niveli i ngricave janë marrë edhe masa për pastrimin e tyre. Aksidentet e trafikut kemi pasur vetëm 5 raste me dëme materiale kurse janë shqiptuar 172 gjoba. Rastet ku minoritetet janë ankuar kemi vetëm një rast ai është vjedhje e pllakës të dy gazetarëve rrugës për në Zogisht të cilët dyshohet se janë kidnapuar gjatë luftës së fundit. Do flas pak më shumë rreth rastit të vjedhjeve në fshatin Opterushë, kam biseduar edhe me Kryetarin e fshatit edhe me anëtarët e Qeverisë këtu dhe atje edhe me viktimat jemi në kontakt permanent, ne i kemi 4 raste të kompletuara të vjedhjeve dhe 3 janë në procedurë ngase mungon nga një element ose mungon pronari i shtëpisë ose mungojnë gjësende të vjedhura pra janë 7 raste në total. Është dhënë edhe një alarm nga një televizion ku ne si Komunë kemi një përvojë të keqe me këtë televizion ngase merren vetëm me kronika të zeza, ne kemi pasur rastet këto 2 vitet e fundit me 3 mësimdhënës me dhunë nëpër shkollë por kjo media i ka dhënë publicitet të madh pa nevojë dhe prapë ky i njëjti medium i ka paraqitur këto raste në media, ne nuk jemi kundër absolutisht me i mbështet ato viktimat që janë dëmtuar qoftë me para qoftë me stoli ari por dua që të ju them se kryesisht kemi të bëjmë me vjedhje në familje. Është vjedhur para dy viteve ari dhe tani mundohen që të ja lënë dikujt përgjegjësinë ose barrën, po ashtu ata duhet që ti arsyetojnë lojërat që luajnë nëpër aparate të fatit, ata e bëjnë një inskenim të vogël në shtëpi, por ne jemi duke punuar me të gjitha njësitet dhe besoj se shumë shpejtë ata do të dalin para drejtësisë. Fshati Opterushë i ka diku afër 400 shtëpi 3540 banorë gjithmonë flasë sipas statistikave, në këtë fshat kemi që banojnë edhe anëtarët e sigurisë, policë të Kosovës, ne jemi duke i ndërmarrë të gjitha masat që nga njësiti i inteligjencës, detektivëve etj. Janë intervistuar diku rreth 20 persona dhe grupi i hajnave është në mesin e tyre, po kjo punë nuk mjafton me propagandë mediale, me presion politik as ndaj Kryetarit të Komunës as ndaj anëtarëve të qeverisë dhe as ndaj policisë së Kosovës, presioni nuk i ndihmon fare procesit të hetimeve, çdo sjellje që ndikon negativisht në procesin e hetimeve është i pa pranueshëm, prandaj ju bëjë lutje të gjithë atyre që kanë ndonjë dijeni në lidhje me këto vjellje të na informojnë. Këto vjedhje janë stopuar pra janë ndalur sepse është prekë aty ku duhet, ne këtu kemi të bëjmë kryesisht siç e cekam më lartë vjedhje në familje, arsyeja pse po e them këtë është sepse nuk është përdorur dhunë, nuk ka kërcënim nuk ka maska, nuk ka armë, nuk ka grabitje, nuk ka kidnapim, pra në momentin që këto

përrjashtohen atëherë hajnat i kemi nëpër tavolinat e kafiterisë ose në shpi në sofër, por ne shumë shpejtë do të arrijmë që ti qesim para drejtësisë ata. Pastaj ky fshat i ka 4 rrugë hyrëse dhe dalje dhe nuk është lehtë që ti mbuloj policia me këto kapacitete që i ka, pastaj nuk mjafton informacioni i thash e thëne se ky apo ai e ka bërë vjedhjen, kanë kaluar ato kohëra kur e kanë marrë dike në shesh dhe kanë varruar pse e tha dikush atë, tani përdoren vetëm metodat shkencore të dokumentimit të fakteve për ta dënuar ose me e shpallë fajtorë dike. Sa për me qen më interesant për juve unë jam policë që 41 vite banorët e fshatit Opterushë asnjëherë nuk kanë qen në agjendë të krimit ose në agjendë të kronikës së zezë për asnjë lloj krimi, 6 vitet e fundit janë vetëm 7 raste të vjedhjeve, tani ndodhën 4+3 që janë pa kompletuar, por besoj se nuk kemi nevojë me alarmua ose që të krijojmë dyshime as ndaj pushtetit por as ndaj neve që jemi pjesë e pushtetit edhe lokal edhe qendrorë. Për fat të keq ne kemi rreth vete aso individ të pakënaqur por ma mirë kishte me qen më mirë që ta demaskojnë vetën ata dhe mos të mirën as me punët e policisë e as me punët e Kryetarit. Në këtë fshat është një market i madh, janë 5 shitore të vogla, 4 bastore dhe 2 kafiteri ato këto janë përplot me rini, aty ke nga ata që luajnë lojëra të fatit kurse as një cent të ardhura nuk e ka, policët e mijë atje që jetojnë, banorët dhe të zotët e shtëpisë e dinë dhe i shohin se kush janë ata, këta persona duhet që ta argumentojnë se ku janë duke i marrë këto para. Ka inskenime kryefamiljari nuk e ka ditur që i ka pasur 240.00 € përfund tepihut, kurse djali tije thotë se këtu i kam lënë unë kurse tani nuk janë mi kanë vjedhur dikush,, pra kjo është inskenim total. Çka është edhe ma keq këtu ka pas individë dhe tendenca që në atë tubim aty por edhe pastaj pas tubimit, disa persona janë paraqitur me armë kinse do ta mbrojnë fshatin, askush nuk ka nevojë ta mbrojnë fshatin ne jemi aty që ta mbrojmë, ka pasur edhe të shtëna për automjet aty a kanë festuar që nuk po munden më të vjedhin apo kanë festuar që kanë vjedhur ne jemi në përfundim të hetimeve dhe do shkojmë deri në fund, nuk ka nevojë atë ta fshehë askush, apeloj të gjithë qytetarët që gjësendet me vlerë të mos i lënë vend e pa vend, nuk është mirë të dilet në qendër të fshatit nëpër kafiteri dhe të tregosh se djali ti ka dërguar 4,000.00 € ai do të mbetet për dy ditë pa para, nuk janë të gjithë të ndershëm aty krimi ka lindur me njerëzimin, vjedhja ka lind me njerëzimin, shteti ka lind atëherë, drejtësia ka lind atëherë, policia ka lindur atëherë dhe secili duhet ta bëjë punën e vet. Nuk është mirë të njollosen ata banorë atje sikur të jetë vatër krimi posaçërisht kur kemi të bëjmë me media të shkruara të cilët i përcjellin mijëra banorë. Ky medium i ka bërë edhe tre inskenime të tjera njërin në shkollën Isa Boletini e cila nuk e ka merituar kurrë asi epiteti, në dy palë zgjedhje në balotazh, ju them sinqerisht se radiotelevizioni i Kosovës raporton nga semafori dhe e qet portën e vendvotimit dhe e thotë se situata është shumë e mirë dhe shumë stabile nuk ka kurrfarë incidenti, kurse ata të tjerët me telefon mua dhe dy prokurorë na thonë se është bërë kiameti aty dhe nga banka janë duke marrë para me çanta dhe janë duke shkepur votuesve në këtë shkollë, ky është vetëm një shembull ka dhe plot shembuj të tjerë. Kemi shembullin e ditëve të fundit me aferën gypave ku dëshirojnë të na qesin para aktit të kryer neve policinë sikurse ka korrupsion atje, po ashtu edhe Kryetarin e Komunës pa kurrfarë kuptimi, pa procedura të tenderimit, pa procedura të prokurimit, pa procedura të hetimit të cilët i kryejnë organet kompetente ata e shpallin atje dike fajtorë dhe sikurse korrupsioni është duke kaluar para hundëve tona, kjo është krejtësisht e pa pranueshme, nuk e di kush janë ata njerëz ose kjo kompani që e bënë këtë, ne i dimë të gjithë po ashtu edhe mediat i dinë ata le ti qesin ata para mediave dhe le ti shohin fytyrat e tyre. Ne si organ shtetëror ose si agjension duhet të keni të qartë të gjithë se nuk bëjmë debat me qytetar, procedurat e debatit janë të rregulluara me ligj, caktohet dita, vendi ora se kur duhet të bëhet debat me biznesin ose me kategoritë e tjera me Kryetarin, kurse ne nuk bëjmë debat nëse kërkohet me debatu atëherë duhet një aprovim sepse unë kam hierarkinë time duhet që të mirët leje, mediat për ngjarjet e Opterushës kanë qen të informuar kanë qen dy komunikata, Kryetari i komunës çdo mëngjes e merë raportin se çka është ndërmarrë nga policia e Kosovës, viktimat e kanë derën e hapur tek ne po ashtu edhe Kryetari i fshatit mundet në çdo kohë të na kontaktoj, ka qen tek unë në zyra ku kemi biseduar rreth një orë, pra vetëm bashkërisht mundemi me i demasku ato veprime që nuk shkojnë në favor të imazhit as të pushtetit duke përfshirë edhe policin po ashtu nuk shkojnë në favor as të atyre njerëzve të fshatit të cilët janë shumë të ndershëm. Sa i përket ngjarjeve në fshatin Opterushë dhe krimit në përgjithësi nuk isha zgjatë më tepër. U bisedua këtu rreth shitjeve të artikujve në trotuare me të drejtë e keni sepse me të vërtet janë duke na ngulfatur, këta persona vinë dhe ankohen tek Kryetari i Komunës pse ne ja heqim kamionin me thëngjill ose 2-3 gajba qe shesin produkte të ndryshme në trotuar, atyre

personave duhet që të ja mbyllni derën ne deri në 3 herë mundemi me i toleru por herën e 4 duhet që ti dënojmë, shitja e mallit në trotuar është kundërvajtje dhe dënohet edhe sipas ligjit të trafikut po ashtu dënohet edhe me rregulloren e kuvendit, ne vitin e kaluar kemi pasur rreth 8000 dënime ose gjoba që janë lëshuar për trotuare, rrugë, semafor etj. U ceken edhe mbeturinat ato jo vetëm që e pengojnë trafikun dhe ambientin por ato paraqesin një rrezik të madhe për shëndetin tonë, kam kërkuar 2-3 herë nga Drejtori i Shërbimeve Publike ndihmë por nga një herë edhe ai nuk ka çka të bëjë, ai më thotë komandant nuk kam as ekskavator as ndonjë kompani e cila mirët me pastrim të mbeturinave. I kemi lutur disa herë qytetarët që ti pastrojnë mbeturinat, por ne si polici nuk do të ndalemi kemi dalur në teren shumë shpesh me Drejtorin e inspektoratit dhe besoj se shumë shpejtë do të gjejmë formulë edhe për këtë problem por edhe ndaj atyre që parkohen vend e pa vend nëpër qytat edhe ndaj këtyre barinjve që i përmendet më herët, atyre duhet patjetër të ja bëjmë një zgjidhje ne kemi bjeshtë prandaj duhet që të intervenohet edhe tek Kryeministri nëse është nevoja që agjensioni i pyjeve të Kosovës të ja ndajë në parcelë dhe ata të hiqen nga qyteti sepse me të vërtetë qytetarët janë në zorrë nga qentë dhe dhentë e tyre besoni që nuk guxojnë me i lënë dyert e oborrin hapur sepse me të vërtetë janë bërë shumë 3 stalla janë në zonat e urbanizuara. Të nderuar anëtarë të KKS-së çdo gjë që ka të bëjë me çështjen e sigurisë, ambientit, shëndetit, trafikut, krimit, kundërvajtjes, po ashtu edhe me ato lokale që gjenden në fshatin Xërxë ku gjitha llojet e krimit të rëndë dhe të organizuar gjenden aty, nëse vini nga ai mesë kishte me qen mirë që të na ndihmoni, nëse ka prostitucion ju i shihni ato femra që lëvizin aty pari ditë e natë, kjo nuk është vetëm punë e policisë neve na duhet mbështetje, informacioni, bashkëpunim që të mundemi me ja arit qëllimit, ju faleminderit.

**Skender Krasniqi**, Drejtor i Shkollës Fillore Opterushë – Përsëritet për gjithë të pranishmit, unë përfaqësoj këshillin e fshatit Opterushë, është biseduar goxha shumë për fshatin tonë sonte këtu, me të vërtetë ka qen një situata jo e lakmueshme dhe shqetësuese për banorët e fshatit, jemi ballafaquar me një dukuri negative të hajnisë brenda 7-8 nate të muajit shkurtë kanë ndodhur disa raste, sa jam në dijeni Kryetari ka bërë kërkesë që në rastet e parë por nuk është ndërmarrë asgjë nga ana e rendit të sigurisë, prandaj ne si kryesi jemi detyruar që ti mbledhim banorët e fshatit ose kryefamiljarët në një mbledhje e cila është mbajtur me 25.02.2018, për të diskutuar rreth këtij problemi. Banorët ishin shumë të shqetësuar dhe shumë në panik aty kishte fjalë të ndryshme, kishte edhe revoltë në mesin e banorëve. Ne në atë mbledhje nga bashkëfshatarët kemi kërkuar që të jenë vigjilent, kemi kërkuar nga çdo kryefamiljar që ti kontrolloj fëmijët e vet sidomos pjesën e rinisë siç e ceku edhe komandanti ata janë pa kurrfarë të hyra kurse mirën me aktivitete të ndryshme jo të mira. Në fshatin tonë janë 4 bastore, nuk e di a kanë licencë ose leje pune këto bastore, prandaj besoj se ata të cilët luajnë këto lojëra i kanë kryer edhe këto akte të dëmshme, po ju përcjelli mesazhin e kryesisë dhe banorëve të fshatit Opterushë që nga ana e organeve të rendit të ndriçohen sa më parë këto raste, të mos zgjatet shumë kjo punë dhe të dihet se kush janë këta kryes të veprave të vjedhjes dhe të ju jepet dënimi i merituar.

**Marian Shariq**, nënkryetar i KLSP-së – Përsëritet për gjithë të pranishmit, komandanti i stacionit policor në Rahovec e ceku problemin e stallave e cila gjendet në hyrje të fshatit Hoçë e Madhe, problemi tjetër është se rrugët kryesore nga Rahovec – Malishevë dhe Rahovec – Suharekë mungojnë sinjalizimet e në veçanti kur është koha e keqe dhe me mjegull, kërkoj nga Kryetari i Komunës që të kërkoj nga organet përgjegjëse që ti sigurojnë këto ndriçime, po ashtu që të rregullojnë sinjalizimin e vijave të bardha në këto rrugë. Ky këshill ka aprovuar një projekt për vendosjen e kamerave ku në qytetin e Rahovecit janë vendosur gjithsej 8 kamera, kishte me qen mirë që Kryetari i Komunës ta përkrah këtë projekt dhe të vazhdojë që të vendosen kamerat e sigurisë në të gjitha lokalitetet e Komunës sepse para disa dite në fshatin Hoçë e Madhe është larguar flamuri nga përmendorja, po ashtu është thyer pasqyra anësore e një mikut tim edhe pse kamare ka në atë lagje por ndoshta e kanë shfrytëzuar kohën kur nuk ka pasur rrymë. Po ashtu rruga Bekim Isma e cila e lidhë lagjen e epërme me fshatin Hoçë e Madhe është shumë e ngushta dhe kishte me qen mirë që kjo rrugë të zgjerohet dhe të ndriçohet në mënyrë që të kenë mundësi qytetarët të ecin edhe në orët e vona në këtë pjesë.

**Osman Ismajli** – I nderuari z. Marian Vjedhja e flamurit dhe dëmtimi i përforcuesit të flamurit ka ndodhur me 01.03.2018, unë jam duke raportuar për muajin e kaluar e jo për këtë muaj kjo është arsyeja pse nuk e kam përmendur këtë ngjarje, sa i përket thyerjes së pasqyrës së makinës mua për çdo ditë janë duke mi thyer pasqyrat e policisë sepse si e le diku keq makinën dikush kalon dhe ta thyen, pra vetura

është e papranueshme që të parkohet në rrugë. Po i përgjigjem edhe z. Skender Krasniqit, i nderuar në momentin që banorët e fshatit i shohin patrullat e policisë në fshat atëherë aty nuk ka preventiv, nuk ka punë operative dhe nuk ka hetime, kurse ata që nuk shihen fare ata e kryejnë punën e vetë më së miri, pra mos u mbështetni se nëse e shihni patrullat atëherë puna është mirë, pra veprimet taktike operative masat dhe metodat kriminologjike nuk ka nevojë që ti dinë fshati dhe as ju sepse ato duhet që të jenë të padukshme.

**Nysret Abazibra** – Përfaqësuesi i Këshillit të BI Rahovec – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, e dëgjova me vëmendje raportimin e komandantit të policisë, ajo që më shtyri që të marrë fjalën ishte jo vetëm kjo ndodhi por shkaku që i ka shtyrë me ardhur deri tek këto vjedhje, u përmend se në fshatin Opterushë janë rreth 4 lokale të bastoreve, për mua është shqetësuese se në këtë fshat ka vetëm 1 shkollë, 1 xhami kurse ka 4 bastore, do të ishte mirë që të shikohet në aspektin ligjor se a i kanë përmbushur kriteret këto lokale për me u hapë, pastaj sa është largësia prej shkolle, pastaj sa banorë janë në këtë fshat, nëse nuk mundemi me i mbyllë të gjitha së paku të i minimizojmë. Kishte me qen mirë që të analizohet se si është gjendja nëpër fshatrat e tjera me këto bastore, pra mos të na ndodhin edhe në fshatrat e tjera të njëjtat pasoja është mirë që ti parandalojmë, prandaj kisha kërkuar nga organet kompetente që të zbatohet ligji në përpikëri. Çështja e dytë që desha të ngrisë ka të bëjë me shkollën ardhmëria, e di se Komuna është e njoftuar me këtë rast, kishte me qen mirë që të mirët ma seriozisht çështja e atij muri sepse ka të bëjë me sigurinë e jetës së fëmijëve, mos të na ndodhë zoti na ruajte ndonjë aksident e pastaj ne të merremi me pasoja, kishte me qen mirë që kjo të jetë si prioritet.

**Osman Ismajli** – Ne në Komunën tonë kemi dhjetëra lokale të fatit që i quajmë ekskluzivisht unë nuk e di as kush janë duke u marrë me këto lokale, ato janë në përgjegjësi të doganave të Kosovës dhe ATK-së, po ashtu është përgjegjësi e njësitit qendrorë të krimeve ekonomike që të mirën me ta. Nëse keni dëshirë do ju sjelli kërkesat që i kam dërguar këtij njësitë që të mirën me këto bastore. Mendoj se në fshat secili prind duhet që ti kontrolloj fëmijët e vetë dhe mos ti lejojë që të shkojnë nëpër këto lojëra të fatit se përndryshe do ti vidhen gjitha sendet me vlerë dhe do të përfundojnë në këto lokale të fatit. Sa i përket atij muri që paraqet rrezik që e tha i nderuari z. Nysret Abazibra, ne kemi në disa vende aso mure që paraqesin rrezik, janë ndërmarrë masa çdo herë edhe këtu duhet që të dele inspektorati po ashtu edhe patrulla e policisë së komunitetit që ta bëjë një raporte ose një ekspertizë të vogël dhe të shihet se i kujt është ai mure a është i shqiptarit, i serbit apo i romit, a është ai këtu apo jo, të bëhet edhe verifikimi i pronës në Komunë e pastaj të bëhet një vlerësim profesional nga inxhinierët e Komunës se a paraqet ai mure rrezik për jetën e qytetarëve.

**Shaip Shala**, Përfaqësuesi i mediave – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, kam një pyetje për komandantin e nderuar, po paraqitem si anëtar i këshillit e jo si gazetar, në bisedë formale me disa banorë të fshatit Malësi e Vogël më kanë treguar se kanë ndodhur edhe disa vjedhje edhe në këtë fshat, po ashtu më thanë se një plak e kanë lidhur hajnat, pyetje ime është a është e vërtetë kjo dhe nëse po a janë raportuar këto raste në stacionin policor.

**Osman Ismajli** – I nderuar z. Shaip Shala askënd nuk e kanë lidhur në oborr, në fillim apelova që mos të zmadhohen gjërat, ka pasur vjedhja të pajisjeve të banjave të cilat kanë qen në ndërtim e sipër, ka pasur disa vjedhje të disa veglave të punës rastet janë të hapura jemi duke i hetuar.

**Ylvi Shehu**, përfaqësuesi nga Teqja e Madhe “Shejh Sylejmanit”- Përsëritet për të gjithë të pranishmit, do të inkadrohem në këtë bisedë jo si përfaqësues i një komuniteti por si përfaqësues fetar. Së pari do kisha biseduar si qytetar, jam në moshën 67 vjeçare,, komandantin e njoh edhe personalisht edhe si udhëheqës në vitet e 80, do e kish bërë një pyetje ne kërkojmë të drejta nga shteti por a pyesim ne ndonjëherë si qytetar se çka kemi ne për obligim ndaj qytetit së pari, ndaj sigurisë së qytetit dhe çka kemi ne përgjegjësi ndaj shtetit. Të gjitha këto shqetësime që i ceken parafolësit ishin shumë reale, sa i përket fshatit Opterushë unë i kam përmbi 60 vjet dhe e di që në të kaluarën ky fshat ka qenë njëri nga fshatrat që është mare si shembull për të mirë, përfaqësues të Komunitetit nga Teqja e Madhe “Shejh Sylejmanit”, ky fshat që nga vitet e 80 –ta i ka të martuara në Rahovec mbi 70 vajza, pra një lidhje qytet fshat, çdo kohë i ka njerëzit e vetë prandaj besoj se edhe fshati Opterushë do ti tejkalojë këto probleme së bashku me organet e rendit. Sa i përket sigurimit të trafikut me të vërtetë kjo është shqetësuese sepse rrugët në qytetin tonë janë shumë të ngushta, por ne në anën tjetër duhet që të mendojmë edhe për

bizneset, ne i kemi në Komunën tonë 3 biznese të mëdha tregtare ku 90 % të bizneseve të vogla janë ngulfatur, por duhet të dimë se bizneset e vogla janë ata të cilët kontribuojnë më së shumti me tatime në Komunën tonë. Nuk e di a e keni vërejtur se shumica lokaleve të vogla në Komunën tonë janë të zbrazëta kjo edhe për syrin e njeriut nuk duket mirë, kur punojnë në një qytet lokalet e vogla, të mëdha dhe ato që mirën me zanate të ndryshme edhe qyteti duket më i gjallë por edhe komuna ka më shumë të ardhura. Qyteti i Rahovecit në ditën e shtunë dhe të diel është i boshatisur si nuk punon kuvendi komunal edhe qyteti nuk ka lëvizje, pse në Prizren ka me dhjetëra parkingje private kurse në Rahovec nuk ka asnjë por edhe ai që është nuk punon, komandanti dhe policia duhet që të mirën me ne dhe ne duhet që tumiremi me ta, ata nuk kanë dikën tjetër të mbrojnë përveç qytetarët, po ashtu nuk kanë dikën tjetër që të dënojnë përveç neve. Por nuk është gjithçka zi në këtë Komunë sepse bëhet një jetë e qet, ka një bashkëjetesë ne duhet që të jemi të bashkuar dhe ti tejkalojmë ato barrierat e vjetra.

**Osman Ismajli** – Janë disa periudha gjatë ditës si shkuarja dhe ardhja e nxënësve si dhe shkuarja dhe ardhja e punëtorëve të administratës me të vërtetë në këtë kohë bëhet më tollovi mirëpo rruga kryesore e Rahovecit nuk është aq e ngarkuar sa mos të lëmë dikë që të pranojë mallin në lokalitë e tij. Janë disa furgonë që çdo ditë që për një pako cigare e bllokojnë rrugën, ne mundemi të ja rregullojmë atyre një regjim që kur me pas të drejtë me e pranuar mallin, duhet që ti kenë katër indikatorë të ndezur sepse ne nuk kemi trotuare aq sa duhet deri tek qendra, mirëpo ne kemi punë atje dhe është obligim i qytetarëve që sa më pak të pengohet edhe trafiku edhe këmbësorët edhe të gjitha. Ju faleminderit.

**Ramë Berisha**- Përfaqësues i Komunitetit RAI – Përhëndetje për të gjithë të pranishmit , kërkoj që të bëhet intervenimi në anësoret e rrugëve pasi që është rrugë që frekuentohet nga nxënësit dhe dëmtimi i këtyre anësoreve paraqet rrezik për ta, këto anësore dimensionin e kanë 6 me 1m kishte me qenë mirë që nëse ka mundësi që të rregullohen këto anësore dhe të vendosen në vendin e tyre, për këtë rast janë të informuar edhe policia.

**Kryetari** – Falënderoj të gjithë ata që diskutuan duke besuar në përkushtimin dhe rolin që e kemi si KKSBB për ti arritur objektivat e caktuara që janë. Sipas ligjit është një mekanizëm jashtëzakonisht i fuqishëm i cili kontribuon direkt në rregullimin e sferës së shoqërisë në Komunën tonë duke ju uruar secilit veç e veç mandatin e ri sepse jeni zgjedhur nga anëtarët e Kuvendit, besoj se roli i këtij Këshilli do të fuqizohet në vazhdimësi dhe ne së bashku do ta kryejmë detyrën të cilën e kemi marrë përsipër. Këtu u potencuan disa probleme të cilat doemos duhen zgjidhur, nuk flas për stallat të cilat bëhen problem sepse ne nuk kemi probleme ndëretnike kemi një bashkëjetesë normale, stallat të cilat gjenden tek Bërnjaka po ashtu edhe ato në periferi të qytetit, si dhe ajo që gjendet në hyrje të fshatit Hoçë e Madhe, ne e kemi pasur një takim me fermerët ku e kemi trajtuar këtë çështje dhe besoj se kanë filluar të paraqesin fermerët sepse ne jemi të interesuar që të i lëvizim këto stalla dhe të zhvendosen diku në pjesët më të përshtatshme. Sa i takon sinjalizimit të rrugëve rajonale dhe lokale mundë të ju them se ne kemi jashtëzakonisht interes ne kemi disa projekte që besoj se do ta kompletojnë ndriçimin publik në qytetin e Rahovecit. Ne natyrisht që kemi probleme me ndriçim publik edhe nëpër vendbanime më të mëdha por besoj se me DEMOSIN ose me ndonjë organizatë tjetër të huaj do ja arrijmë qëllimit që ti ndriçojmë të gjitha vendbanimet, me ndriçim mendoj se do të pamundësojmë çfarëdo kanosje që ndoshta vije për shkak të errësirës. Sinjalizimi i rrugës rajonale për në Malishevë ne do të i drejtohem Ministrisë përkatëse sepse ajo është rrugë rajonale e cila nuk i takon përgjegjësisë të Komunës së Rahovecit por përgjegjësia e Komunës së Rahovecit është që të kërkojë një sinjalizim më të mirë për rrugët të cilat janë në përgjegjësinë e Ministrisë së Infrastrukturës. Ne kemi marrë mbështetje në një varg projektesh nga Ministria e Infrastrukturës po ashtu besoj se edhe për këto do të marrim mbështetje nga kjo Ministri. Zgjerimi i rrugës “Bekim Isma” ose përkujdesja ndaj rrugëve të ngushta ne kemi biseduar edhe me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe ne do të kujdesemi që ato rrugë të cilat nuk kanë probleme serioze me prona do të i zgjerojmë, do ti ndriçojmë dhe do të i mirëmbajmë sa më mirë që mundemi. Kamerat e sigurisë po ashtu janë problem sa herë që ngritën qoftë nga Drejtoritë e Shkollave qoftë nga Komunitetet, me të vërtetë kamerat e sigurisë janë kontribut dhënës në përmirësimin e sferës së sigurisë së përgjithshme në Komunën e Rahovecit. Ne kemi në projeksionet tona diçka, nuk jam nga ata të cilët ankohen, ne mund të kemi vështirësi në vitin e parë sepse është bërë planifikimi një vit më parë dhe ne kemi gjetur këtë planifikim por sidoqoftë kurdo që do të mundemi ne në lirin e hapësirave publike në

zgjerimin e rrugëve, ndriçimin e rrugëve, në vendosjen e kamerave të sigurisë do të marrim përsipër që të llojmë dhe të përgatisim projekte dhe kërkesa dhe të fitojmë sa më shumë projekte të tilla që e rregullojnë sferën e sigurisë në Komunën tonë po ashtu në këtë aspekt hyjnë edhe bastoret, lojërat e fatit në qoftë se bie fjala KKSBB-ja që në këtë drejtim të ndërmarrin diçka po ashtu edhe nga Policia atëherë ne do të i adresohemi seriozisht ATK- së dhe doganave të Kosovës pra do ta mobilizojmë inspektoratin tonë i cili edhe nëse nuk mundet asgjë të bëjë pavarësisht se në kompetencat e kujt janë ato lojëra të fatit ata munden që të vendosin drynin deri sa të vinë ata që të japin sqarime. Për asnjë çmime dhe asnjë kusht nuk lejojmë që të rrezikohet gjendja e sigurisë nëse ne kemi zhvillime të tilla në fshatin Opterushë apo diku tjetër. Sa i përket shtëpive të natës të cilat gjinden në Komunën tonë pavarësisht se Komuna e Rahovecit merr taksa nga këto shtëpi të natës ju e dini që njëherë unë i kam ndaluar dhe nëse më vjen diçka nga Policia dhe nga KKSBB-ja unë e kam edhe vullnetin edhe gatishmërinë që të i ndërpres këto aktivitete të cilat e cenojnë edhe pronën edhe jetën e qytetarëve, së paku do të mundohemi që ti pezullojmë aktivitetet e tyre, gatishmëria e Kryetarit të Komunës dhe ekipit të tij do ta kemi gjithmonë; ne jemi duke pritur sugjerimet e organeve kompetente të cilat më drejtpërsëdrejti janë të fokusuara në çështjet e sigurisë, në mënyrë që ne të kemi bazë ligjore më të mjaftueshme për të vepruar si Komunë. Sa i përket mbeturinave ky këshill duke më përfshirë edhe mua si kryesues i këtij këshilli mundemi të i tregojmë banorëve se çfarë roli ka, po ashtu ne mundemi të i informojmë ata se hedhja vend e pa vend e mbeturinave gjobiten prej 5.00 € deri në 100.00 €, qoftë të amvisërisë apo inerte. Ne mundë të mos kemi kapacitete të bollshme që të monitorojmë komplet këtë proces për arsye se ne e dimë se sa inspektor kemi, po ashtu ne mundemi të disponojmë fakte të mjaftueshme sa me i gjobitë ata të cilët e ndotin dhe e prishin ambientin tonë. Mendoj se KKSBB-ja po ashtu edhe unë si Kryetar i Komunës besoj se mundemi me mare një rolë të veçantë paralajmërimi se hedhja e mbeturinave vend e pa vend janë të ndaluara. Kisha mirëprirë një kërkesë nga KKSBB-ja që eventualisht të rivendoset taksa e cila kushtëzon regjistrimin e automjeteve me pagesë të mbeturinave, mundet të thotë dikush se nuk është e ligjshme kjo por ju siguroj se shumica e Komunave të Kosovës veç e kanë këtë taksë si kushtëzim. Besoni se kemi me qen dëshmitar se kemi ma pa shumë më pak mbeturina e sidomos mbeturina të amvisërisë nëse e rivendosim këtë taksë. Ne këtë vite në funksion të përmirësimit të gjendjes së sigurisë nëpër fusha që janë si dëmtimi i kulturave bujqësore gjatë sezonës nga elementet e pa përgjegjshëm, këtë vit ne së bashku me kolegët e mijë kemi marrë një vendim që të vendosim 3 rojet e fushës të cilët do të kenë bashkëpunim me inspektoratin e Komunës së Rahovecit, policin e Kosovës, këta roje do të kenë vetëm një detyrë ruajtjen e kulturave bujqësore, kjo ka qen kërkesë edhe në mandatin e parë që e kam pasur,, por ka qen kërkesë edhe në mandatin e z. Vehapi po ashtu ka qen kërkesë e vazhdueshme edhe tani. Mungesa e parkingjeve edhe për këtë jemi të vetëdijshëm dhe synimet tona afatshkurtra do të bëjmë përpjekje që disa rrugë kryesore dhe aty ku kemi pak hapësirë të krijojmë ose parkingje ose të vendosim sinjalistikë të mjaftueshme që rrugët e ngarkuara me një ekspertizë të kompetentëve do të shohim mundësin që në të ardhmen ta shohim mundësin e ndryshimit të qarkullimit të automjeteve në trafik. Do të shikojmë se a ka mundësi që disa rrugë të qytetit të bëhen njëdrejtimëshe, por për këtë nuk do të vendosim ne përmendësh por do të ftohen që të japin mendimin dhe kontributin e tyre policia, ekspertët e komunikacionit, të auto shkollës, pastaj inxhinierët e urbanizmit dhe ata do ta thonë fjalën e tyre. Pastaj në disa vende kemi situatë bllokuese të trotuareve , kemi probleme në disa rrugë të qytetit me trotuare sepse nuk kemi trotuare, do të shikojmë se ku aty ku kemi mundësi për ti liruar trotualet do ti lirojmë, por aty ku janë trotualet dhe janë të bllokuar mendoj se nuk është e mirë dhe nuk është e këndshme të shihen aty makinat e parkuara, mendoj se kjo nuk është një kontribut në dëme të bizneseve më se dikush ashtu e tha, e di se disa kanë leje nga Komuna për vendosjen e produkteve të tyre por kjo nuk do të thotë që ata kanë leje që ta zënë komplet trotuarin, duhet të kihet më shumë vëmendje sepse nëse uzurpohet trotuari ka rrezik permanent që të dëmtohet këmbësori në çdo moment. Po ashtu ne si Komunë kemi problem edhe me rreth rrotullimet, ne do të shikojmë mundësin e ndërtimit të rreth rrotullimeve aty ku ka nevojë, pastaj vendosja e shenjave sinjalistike të trafikut aty ku ka nevojë ne për këtë kemi një plan dhe një projekt, po ashtu edhe rreth rrotullimet që janë ekzistuese do të shohim se çka do të thonë ekspertët se a ka mundësi që të riorganizohen ato më mirë në mënyrë që të jenë më funksional sidomos ai që është tek rasat e Rahovecit dhe ai që gjendet tek rija, të gjitha këto çështje që kanë të bëjnë me sferën e sigurisë dhe që e

ndihmojnë një funksionim më normal të qarkullimit për qytetarët tanë besoj se me një bashkëpunim më të mirë të KKS-së, të organeve kompetente të Komunës, me institucione e policisë, me FSK-në, me shoqëritë civile dhe mediat, besoj se do të ishte shumë më mirë që ti shfrytëzojmë këto rrethana dhe para se të jepet ndonjë lajm nga ndonjë televizion ashtu siç e potencoi edhe Komandanti i policisë le të jepet lajmi një herë nga Kryetari i Komunës, Komandanti i Policisë ose ata që janë kompetent dhe që janë përgjegjës për të dhënë lajmin, nëse ne e lajmërojmë ndonjë televizion ose ndonjë portal pa i përfill këto rregulla të lojës atëherë mendoj se nuk e kemi kryer punën tonë ashtu siç duhet. Besoj se nuk është mirë që Kryetari i Komunës ose Komandanti i policisë të merre një lajmë nga televizioni ose portalet e ndryshme, por nëse ne nuk ju përgjigjemi atëherë është normale që të kërkohet zgjidhje në adresa të tjera. Ju ftoj edhe një herë që ta rrisni rolin, angazhimin dhe bashkëpunimin, po ashtu ju urojë suksese të përbashkëta në misionin shumë fisnik që e keni para vete që siguria në Komunën e Rahovecit të jetë e qëndrueshme si rezultat i angazhimit të punës sonë të përbashkët. Me të gjitha këto që i biseduam i përfshimë edhe dy pikat e radhës ai ajo Përfundimet dhe Rekomandimet nga takimi i KKS-së dhe të ndryshme. Nëse nuk ka askush të ngrisë ndonjë shqetësim tjetër sa i përket kësaj pike e deklaroj të mbyllur këtë takim shihemi në takimin e radhës.

**Mbledhja përfundoi në orën 11:45**

